

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE  
“ SCAN ” SHA TIRANË**

**Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019**

**TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL**

**1. Organizimi, Kontributet, Objekti dhe Pronesia.**

Shoqeria “SCAN” Tirane eshte krijuar si shoqeri anonime mbi bazen e Vendimit te Gjykates se Tiranes Nr. 23760 dt 09.05.2000 ,me kapital themeltar 2.000,000 leke.

Ne Vendimin e mesiperm te gjykates, emri i shoqerise ka qene Mediasat. Me date 01.02.2010 me ceshtjen nr CN-342949-02-10 emri i shoqerise u ndryshua nga Mediasat ne Scan. Shoqeria “SCAN” me seli ne Tirane eshte shoqeri anonime. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria “SCAN” sh.a. Tirane eshte regjistruar ne Degen e Tatimeve Tirane me nr. NIPTI K12312001A .

**Objekti**

Shoqeria “SCAN” sh.a. Tirane ka objekt te saj: Veprimtari radiotelevizive dhe pergjithesisht cdo operacion financiar tregtar, indistruar me pasuri te palujtshme ose te lujtshme qe mund te lidhet drejtepersedrejti ose terthorazi me ushtrimin e veprimtarise radiotelevizive.

**KAPITALI**

Kapitali i shoqerise sipas Vendimit te rregjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane Nr. 23760 dt 09.05.2000 eshte 2,000,000 leke.

Me vendimin e gjykates 23760/1 date 11/10/2000 kapitali i shoqerise eshte rritur nga 2,000,000 ne 105,673,000 leke.

Me ceshtjen nr CN-314520-08-19 date 13.09.2019 kapitali i shoqerise eshte rritur nga 400,000,000 leke ne 431,048,500 leke, i ndare ne 4,310.485 aksione me vlere nominale 100 leke/aksioni.

Kapitali i shoqerise zoterohet nga keto aksionere:

- Zoti Thoma Minga, i cili zoteron 9,81 % te aksioneve;
- Zoti Adrian Pere, i cili zoteron 4,90 % te aksioneve;
- Zoti Astrit Hana, i cili zoteron 33,61 % te aksioneve;
- Zoti Artan Xhori, i cili zoteron 10,16 % te aksioneve;
- Zoti Aleksandër Pilo, i cili zoteron 12,29 % te aksioneve;
- Zoti Fuad Haxhiymeri, i cili zoteron 9,28 % te aksioneve;
- Zoti Neritan Dojaka, i cili zoteron 9,28 % te aksioneve;
- Zoti Renis Tërshana, i cili zoteron 10,67 % te aksioneve;

**A. Baza e pregatitjese se Pasqyrave Financiare**

**a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat Financiare te shoqerise jane pergatitur ne te gjitha aspektet e tyre materiale, ne perputhje me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004, "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura date 15.06.2006.

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e koston historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohet ndryshe ne se ka te tilla.

**b. Ndryshime ne politikat kontabel**

Gjate vitit 2019 nuk ka ndryshim ne politikat kontabel. Ato jane te njejtat politika te cilat jane zbatuar dhe ne periudhen e kaluar.

**c. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel**

Rishikimi i vleresimit kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte kryer dhe ne cdo periudhe qe preket ne te ardhmen.

**d. Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise. Informacioni financiar eshte paraqitur ne Leke.

**l. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel**

Politikat kryesore kontabel te zbatuara nga shoqeria jane te pershkruara ne vijim:

**e. Vleresimit te likujditeteve**

Gjendjet e likujditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke dhe ne monedha te huaja. Gjendjet e bankave ne monedha te huaja ne 31.12.2018 jane konvertuar me kursin e Bankes se Shqiperise ne 31.12.2019.

**f. Vleresimin e kerkesave per arketim**

Kerkesat per arketim vleresohen me vleren nominale (te skontuara nese eshte materiale) minus humbjen nga zhvleresimi.

**g. Vleresimin e detyrimeve te pagueshme ndaj furnitoreve**

Detyrimet ndaj furnitoreve jane te vleresuara mbi bazen e vleres se tyre nominale.

**h. Huate**

Huate e marra me interes regjistohen fillimisht me vleren e drejte. Pas njohjes fillestare vleresohen me koston e amortizuar. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perlllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

**i. Veprimet ne monedha te huaja**

Transaksioneve ne monedhe te huaj regjistohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019. Diferencat nga kursi i kembimit te linduara nga perkthimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne daten kur vlera e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2019, ka qene respektivisht si me poshte:

	2019	2018
1 Euro	121,77all	123,42 all

**j. Vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.**

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Koston e inventarit llogaritet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar.

Gjendjet e Inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar kete vleresim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme:

**k. Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston se marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Normat e amortizimit te aplikuara jane sipas kerkesave fiskale dhe nuk marrin ne konsiderate vleresimin e amortizimit sipas jetes se dobishme te aktivitet.

Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar norma amortizimi:

Mjete Transporti

Pajisje zyre e informatike

Llogaritja e amortizimit per AAM e hyra gjate vitit behet duke filluar nga data nje e muajit pasardhes.

**l. Provizionet**

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

**m. Te Ardhurat**

Te ardhurat nga sherbimet regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, panvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

**n. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor. Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo rregullim ne tatimet per tu paguar qe rrjedh nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte 15% .

#### o. Fondi i pensioneve

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurime shendetsore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetesore. Nuk ka asnje detyrim tjetër ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendetesore.

## II – SHPJEGIME TE ZERAVE TE PASQYRAVE FINANCIARE ( BILANCIT KONTABEL )

Pasqyrat Financiare (BILANCI KONTABEL) te vitit 2019 jane hartuar sipas formatit te percaktuar ne SKK Nr. 2.

Çelja e llogarive te vitit 2019 rakordon me mbylljen e vitit 2018.

Grupet, rubrikat dhe postet per ushtrimin e mbyllur 2019 dhe ushtrimin paraardhes 2018 rezultojne si me poshte:

### I. Aktivët Afatshkurtera

1. *Aktive monetare. Vlera 15,031,380 leke.*

Nr	Aktive monetare	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	> Banka	4,877,345	3,696,864
2	> Arka	10,154,035	131,966
	Totali	15,031,380	3,828,830

Ne kete ze te bilancit paraqiten likuiditete dhe vlera arke te tjera me gjendjen fizike te tyre te dates 31.12.2019 sipas librit te arkës dhe konfirmave bankare te kesaj date. Vleresimi i bankes ne valute eshte bere me kursin e bankes te dates 31.12.2019.

(1 euro=121,77 all 1USD= 108,64 all)

3. *Aktive te tjera financiare afatshkurtra . Vlera 34,228,362 leke.*

Nr	Aktive te tjera financiare afatshkurtra	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	> Kliente per mallra, produkte e sherbime	34,228,362	43,894,525
2	> Tatim mbi fitimin	0	0
3	➤ TVSH	0	0
3	> Debitore kreditore te tjere	0	0
	Totali	34,228,362	43,894,525

Detyrimi i klienteve ne vleren 34,228,362 leke eshte i njohur dhe i analizuar nga ana e shoqerise.

## II- AKTIVET AFATGJATA

AKTIVET Afatgjata te shoqerise rezultojne me vlere neto 445,686,450 leke.

Aktivitet Afatgjata te shoqerise perfaqesohen nga:

1. Aktivitet Afatgjata Materiale 434,427,982 leke

Shoqeria gjate vitit 2019 ka patur hyrje ne aktivet afatgjata materiale ne vleren 19,873,356 leke ne zerat e AAM. Amortizimi ne vitin ushtrimor eshte rritur me 4,458,163 leke per vleren e amortizimit te vitit ushtrimor 2019.

Aktivitet jane paraqitur ne bilace me vlere neto (vlere kontabel minus amortizimin e akumuluar).

2. Aktive afatgjata jo materiale ne vleren 11,258,468 leke, paraqet vleren e te drejtave televizive te blera nga shoqeria.

**Ne Pasiv te Bilancit** paraqiten ne postet e tyre te rregullta:

*Pasivet Afatshkurtra me vlere 50,923,266 leke , paraqiten me strukture si me poshte:*

2. "Huamarrjet" Paraqitet ne bilac shuma 35,045,821 leke dhe perfaqson hua te marre nga bankat nga shoqeria per blerje.

3.. Huate dhe Parapagimet 15,877,445 leke me strukture:

Nr	3 Huat dhe parapagimet	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	> Te pagueshme ndaj furnitoreve	8,377,855	13,689,288
2	> Te pagueshme ndaj punonjesve	5,175,790	5,587,639
3	> Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.	1,502,243	1,571,952
4	> Detyrime tatimore per TAP-in	492,573	452,965
5	> Detyrime tatimore per Tatim Burim	0	48,000
6	> Detyrime tatimore per TVSH-ne	328,984	58,110
7	➤ Arketim ne avance per porosi	0	0
	<b>Totali</b>	<b>15,877,445</b>	<b>21,407,954</b>

Ne kete post(1) paraqitet detyrimi i shoqerise ndaj furnitoreve per blerje mallrash. Ky detyrim eshte i analizuar. Detyrimet jane te kerkueshme.

Per furnitoret e shprehur ne valute eshte bere rivleresimi dhe diferencat qe kane rezultuar kane kaluar ne rezultat.

Ne detyrime ndaj punonjesve(2) paraqitet detyrimi i shoqerise ndaj punonjesve per pagat e muajit Dhjetor te likujduara ne Janar 2020.

Ne detyrime ndaj shtetit per sigurime shoqerore e shendetesore, Tap dhe Tvsh, jane paraqitur detyrimet e shoqerise per muajin Dhjetor 2019, te cilat jane paguar ne Janar 2020. Keto shuma jane te njejta me ato te paraqitura ne FDP perkatese te muajit Dhjetor.

II. *Pasivet Afat gjata*

Nr.	Emertimi	Gjendja 31.12.2019	Gjendja 31.12.2018
	1. Hua bankare	37,520,980	44,137,987
	2 Huamarrje te tjera afatgjata		
	3. Grantet dhe te ardhurat e shtyra	1,221,681	463,221

Ne kete poste te bilancit jane paraqitur huaja e marre prej shoqerise nga banka, me afat mbi nje vit.

III. Kapitallet paraqiten ne bilanc 411,753,731 leke me strukture:

Nr	KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	3 Kapitali aksionar	431,048,500	400,000,000
2	8 Rezervat e tjera(nga rivleresimi)	36,195,000	36,195,000
3	9 Fitimet e pa shperndara	-56,009,667	-58,454,269
4	10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar	519,898	2,444,602
	Totali	411,753,731	380,185,333

### III - INFORMACION SHPJEGUES PER PASH

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte pergatitur sipas Formatit Nr. 1 te percaktuar ne SKK Nr. 2 .

Ne PASH ne postin shitje neto paraqitet vlera e te ardhurave te realizuara nga shoqeria nga aktiviteti kryesor i saj i tregimit te reklamave dhe spoteve publicitare .

Te ardhurat	Gjendja 31.12.2019	Gjendja 31.12.2018
Shitjet neto	134,205,722	148,831,396

Ne krahasim me vitin e kaluar te ardhurat jane ulur me 14,625,674 leke.

Shpenzimet e paraqitura ne PASH dhe kryesisht shpenzimet e blerjeve te materialeve te para, punime dhe blerje furniturash nga te trete jane shpenzime te rregjistruara sipas faturave tatimore bazuar ne cmimin e blerjes.

Ne shpenzimet financiare ne fund te vitit 2019 ne vleren 2,869,361 leke, eshte paraqitur vlera e interesave te huase se paguar 2,852,976 leke dhe diferenca nga kursi i kembimit per 16,385 leke humje dhe 1,631,609 leke fitim.

Ne menyre te analizuar shpenzimet e kryera nga shoqeria gjate vitit 2019 paraqiten:

Nr	Shpenzimet	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	Materialet e konsumuara	16,984,518	24,630,376
2	Pagat e personelit	72,759,409	76,557,006
3	Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetsore	11,804,709	11,324,236
4	Amortizimet dhe zhvleresimet	4,458,163	4,089,775
5	Shpenzime te tjera	24,759,451	26,084,211
6	Shpenzime financiare	2,869,361	3,807,839
	Totali	133,635,611	146,493,443

Posti shpenzime te tjera eshte i analizuar nga ana e shoqerise.

#### **IV - INFORMACION SHPJEGUES PER FLUKSIN MONETAR**

Pasqyra e Fluksit Monetar te vitit 2019 eshte pergatitur sipas formatit te percaktuar ne SKK Nr. 2, Metoda Indirekte. Sipas Pasqyres se Fluksit te Parase te vitit 2019 shoqeria paraqitet me rritje monetare prej leke 11,202,550 leke.

#### **V - INFORMACION SHPJEGUES PER PASQYREN E LEVIZJES KAPITALIT**

Pasqyra e Levizjes se kapitalit eshte pergatitur sipas formatit te percaktuar ne SKK Nr. 2. Sipas Pasqyres se Levizjes se Kapitalit te vitit 2019 kapitali neto i shoqerise eshte 411,753,731 leke.

*Përgatiti: Denisa Shtino*



**Drejtoare e Përgjithshme**

